

O R I O N sh.p.k.
Pasqyrat Financiare më dhe për vitin e mbyllur
më 31 dhjetor 2016

PËRMBAJTJA:

FAQE

PASQYRAT FINANCIARE:

PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR

1

PASQYRA E PERFORMANCËS

2

PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL

3

PASQYRA E FLUKSIT TË MJETEVE MONETARE

4

SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE

5 – 19

ORION sh.p.k.*(Vlerat janë në Lekë)***Pasqyra e Pozicionit Financiar
më 31 dhjetor 2016**

	Shënime	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015
AKTIVET			
Aktive afatshkurtra			
Mjete monetare	4	13,203,106	86,012,250
Llogari të arkëtueshme tregtare	5	802,427,140	1,237,855,732
Të tjera llogari të arkëtueshme	6	3,843,162	2,459,332
Inventarë	7	39,216,225	16,533,005
Parapagime dhe shpenzime të shtyra	8	484,698,382	32,123,461
Totali i aktiveve afatshkurtra		1,343,388,015	1,374,983,780
Aktivitet afatgjata			
Aktive afatgjata materiale	9	33,439,886	32,981,566
Aktive afatgjata jomateriale	10	12,474	14,675
Totali i aktiveve afatgjata		33,452,360	32,996,241
Totali i aktiveve		1,376,840,375	1,407,980,021
DETYRIMET			
Detyrime afatshkurtra			
Hua afatshkurtra	11	35,664,466	18,901
Llogari të pagueshme tregtare	12	165,407,807	89,091,990
Llogari të pagueshme ndaj palëve të lidhura	13	217,190,450	217,578,908
Detyrime tatimore	14	3,550,565	1,309,765
Parapagime të arkëtuara	15	507,631,496	678,317,848
Të tjera detyrime	16	27,337,123	23,229,654
Totali i detyrimeve afatshkurtra		956,781,907	1,009,547,066
Detyrime afatgjata			
Hua afatgjata		-	-
Totali i detyrimeve afatgjata		-	-
Totali i detyrimeve		956,781,907	1,009,547,066
Kapitali			
Kapitali i nënshkruar		39,000,000	39,000,000
Rezerva ligjore		17,488,822	17,488,822
Rezerva të tjera		321,944,133	311,784,751
Fitime të mbartura		-	-
Fitimi i ushtrimit		41,625,513	30,159,382
Totali i kapitalit	17	420,058,468	398,432,955
Totali i kapitalit dhe detyrimeve		1,376,840,375	1,407,980,021

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 5 deri në 19, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

ORION sh.p.k.*(Vlerat janë në Lekë)***Pasqyra e Performancës****Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016**

	Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015
Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit	18	339,859,419	53,625,315
Të ardhura të tjera të shfrytëzimit	19	6,537,374	11,272,097
Lënda e parë, materiale të konsumueshme dhe të tjera shpenzime		(278,442,939)	(7,384,674)
1) Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme	20	(266,807,904)	(2,257,607)
2) Të tjera shpenzime	21	(11,635,035)	(5,127,067)
Shpenzime të personelit	22	(16,255,490)	(18,023,641)
1) Paga dhe shpërblime		(14,323,610)	(15,807,191)
2) Shpenzime të sigurimeve shoqërore/shëndetësore		(1,931,880)	(2,216,450)
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	23	(2,512,328)	(2,456,899)
Shpenzime të tjera të shfrytëzimit	24	(189,435)	(1,332,556)
Shpenzime financiare	25	8,021	17,141
1) Shpenzime interesi dhe shpenzime të ngjashme		8,021	17,141
2) Shpenzime të tjera financiare		-	-
Pjesë e fitimit/humbjes nga pjesëmarrjet			
Fitimi/humbja para tatimit		49,004,622	35,716,783
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin		(7,379,109)	(5,557,401)
1) Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin	26	(7,379,109)	(5,557,401)
2) Shpenzimi aktual i tatimit të shtyrë		-	-
Fitimi/humbja e vitit		41,625,513	30,159,382
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse për vitin		-	-
Totali i të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse për vitin		-	-
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin		41,625,513	30,159,382

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 5 deri në 19, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

ORION sh.p.k.

(Vlerat janë në Lekë)

Pasqyra e Ndryshimeve në Kapital
për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016

Pozicioni më 1 janar 2015	Kapitali i nënshkruar	Rezerva të tjera	Rezerva ligjore	Fitim / Humbja e vitit	Totali
Transferim në rezerva					
Transferim në fitimin e mbartur		23,578,053		(23,578,053)	-
Totali i të ardhura gjithëpërfshirëse për vitin		23,578,053		30,159,382	30,159,382
Pozicioni më 31 dhjetor 2015	39,000,000	311,784,751	17,488,822	30,159,382	398,432,955
Transferim në fitimin e mbartur		10,159,382		(10,159,382)	
Dividendë të paguar				(20,000,000)	(20,000,000)
Totali i të ardhura gjithëpërfshirëse për vitin:				41,625,513	41,625,513
Pozicioni më 31 dhjetor 2016	39,000,000	321,944,133	17,488,822	41,625,513	420,058,468

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 5 deri në 19, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyrat financiare të Shoqërisë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 janë aprovuar nga administratori i ORION sh.p.k. më ____ mars 2017 dhe janë firmosur si më poshtë.

Migene Hana

Hartues i Pasqyrave Financiare



Z. Ardian Nelo

Administrator

Ardian Nelo

ORION sh.p.k.*(Vlerat janë në Lekë)***Pasqyra e Fluksit të Mjeteve Monetare
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016**

Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015
Flukset e parasë nga aktivitetet operative		
Fitim / Humbja e vitit	41,625,513	30,159,382
<i>Rregullimet për shpenzimet jomonetare:</i>		
Shpenzimet për tatimin mbi fitimin jomonetar	-	880,284
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	2,512,328	2,456,899
<i>Ndryshimet në aktivet dhe detyrimet e shfrytëzimit:</i>		
Rënie/(rritje) në të drejtat e arkëtueshme dhe të tjera	434,044,762	412,122,267
Rënie/(rritje) në inventarë	(22,683,220)	(1,246,205)
Rritje/(rënie) në parapagime dhe shpenzime të shtyra	(452,574,921)	(32,093,461)
Rritje/(rënie) në detyrimet e pagueshme	82,275,628	(110,316,068)
Rritje/(rënie) në parapagime të arkëtuara	(170,686,352)	(221,519,195)
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e shfrytëzimit	(85,486,262)	80,443,903
Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit		
Pagesa për blerjen e aktiveve afatgjata materiale	(2,968,447)	(52,500)
Dividentë të arkëtuara	-	-
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit	(2,968,447)	(52,500)
Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit		
Të hyra nga hua afatshkurtra	35,645,565	18,901
Dividendë të paguar	(20,000,000)	-
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit	15,645,565	18,901
Rritje/(rënie) neto në mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare	(72,809,144)	80,410,304
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 1 janar	86,012,250	5,601,946
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 31 dhjetor	13,203,106	86,012,250

4

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 5 deri në 19, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.



ORION sh.p.k.

Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016

(Vlerat janë në Lekë)

1. Informacion i përgjithshëm

Shoqëria "O R I O N" shpk është regjistruar më 12 Maj 1998 në Regjistrin e Shoqërive me vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr.19427 datë 12.05.1998.

Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë është ndërtimi dhe importi i materialeve të ndryshme të ndërtimit.

Kapitali themeltar i Shoqërisë është 39,000,000 lekë i cili zotërohet nga ortakët : Z. Ardian Nelo dhe Z. Niazi Nelo.

Administrator i Shoqërisë është Z. Ardian Nelo.

Shoqëria është e regjistruar pranë degës së Tatim Taksave në Tiranë me NIPT J81715002Q. Selia qendrore e saj është në « Rrugën e Kosovareve », Pallati Orion 2, pranë Kompleksit Dinamo, Tiranë.

Numri i punonjësve më 31 dhjetor 2016 është 25 (2015:16).

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare

2.1. Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara (SKK) dhe ligjin nr.9228, datë 29 prill 2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

2.2. Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

2.3. Biznesi në vijimësi

Pasqyrat financiare të Shoqërisë përgatiten mbi supozimin e biznesit në vijimësi, i cili merr parasysh se Shoqëria do të vazhdojë ekzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të parashikuar.


2.4. Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë paraqitur në Lek, e cila është dhe monedha funksionale e Shoqërisë.

2.5. Vlerësime dhe gjykime

Paraqitja e pasqyrave financiare kërkon që manaxhimi i shoqërisë të kryejë vlerësime dhe supozime që ndikojnë shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve dhe aktiveve e detyrimeve të kushtëzuara në datën e pasqyrës së pozicionit financiar, si dhe të ardhurave dhe shpenzimeve të krijuara në periudhën kontabël.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe bazohen në eksperiencën e mëparshme dhe faktorë të tjerë duke përfshirë pritshmëritë për ngjarjet e ardhshme të cilat besohen të jenë të arsyeshme në rrethanat aktuale. Në disa raste manaxhimi mbështetet në mendimet e ekspertëve të pavarur. Manaxhimi kryen vlerësime dhe gjykime në lidhje me të ardhmen. Vlerësimet kontabël që rezultojnë sipas përkufizimit, jo gjithmonë do të barazohen me rezultatet aktuale. Vlerësimet dhe supozimet që kanë risk të rëndësishëm për të shkaktuar korrigjime (axhustime) materiale, të vlerave të mbartura të aktiveve dhe detyrimeve janë përshkruar më poshtë:



2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare (vazhdim)**2.5.1. Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme**

Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme bazohet në humbjet e vlerësuar të cilat rezultojnë nga pa mundësia e konsumatorëve për të paguar detyrimet e tyre. Këto vlerësime bazohen në moshën e llogarive të arkëtueshme dhe eksperiencën e mëparshme në çregjistrimin, vlerësimin e aftësisë paguese të konsumatorëve, si dhe ndryshimet e fundit dhe të pritshme të termave të pagesës së konsumatorëve. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme.

2.5.2. Provizionet

Provizionet në përgjithësi kërkojnë një nivel të lartë gjykimi, veçanërisht në rastet e konflikteve gjyqësore. Shoqëria vlerëson mundësinë e krijimit të një detyrimi aktual si rrjedhojë e një ngjarje të shkuar, në rast se mundësia e ndodhjes vlerësohet të jetë më shumë se 50% , në të tilla raste shoqëria provizionon vlerën e detyrimit e cila mund të matet me besueshmëri. Për shkak të nivelit të lartë të pasigurisë, në disa raste mund të ndodhë që vlerësimi mund të mos jetë në të njëjtën linjë me rezultatin e çështjes. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për krijimin e provizioneve.

3. Politikat Kontabël

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare.

3.1. Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivitetet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmbehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.


Kursi i këmbimit i monedhave të huaja më 31 dhjetor 2016 dhe 2015 është detajuar si më poshtë:

Kursi i këmbimit	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015
EUR/Lek	135.23	137.28
USD/ Lek	127.18	125.79

3.2. Instrumentat financiarë

Instrumentat financiarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna dhe llogari të pagueshme.

Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbjes, kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë.



3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.2. Instrumentat financiarë

Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivët financiarë çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivit financiar ose kur shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

Mjetet monetare

Mjetet monetare përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së fluksit të parasë, mjetet monetare përfshijnë depozita me afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizionit për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen.

Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë.

Hua të marra dhe të dhëna

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht dhe mbahen në vazhdim me vlerën e tregut, pa përfshirë koston e transaksioneve. Pas njohjes fillestare, huatë e marra dhe të dhëna paraqiten me kosto të amortizuar duke njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve çdo diferencë midis koston dhe vlerës së pagueshme nominale përgjatë periudhës së huamarrjes duke u bazuar (si rregull) në interesin efektiv. Interesat e njohura në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve janë përlllogaritur mbi bazën e interesit nominal.

Vlera e drejtë

Vlerat e drejta të përlllogaritura të mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre, të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimeve për t'u paguar dhe huave, përafrohen me vlerat e tyre kontabël.

Të tjera

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

Kapitali themeltar

Kapitali themeltar njihet me vlerën nominale.



3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.2. Instrumentat financiare (vazhdim)

Zhvlerësimi i aktiveve financiare

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Aktivet financiare të rëndësishme testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivet e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor.

Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivet financiare të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

3.3. Inventarët

Inventarët regjistrohen në kontabilitet me kosto. Kosto e marrjes përfshin të gjitha shpenzimet e kryera për ta sjellë inventarin në vendin dhe kushtet ekzistuese. Në rastin e prodhimit të produkteve në kosto përfshihet edhe pjesa respektive e shpenzimeve të përgjithshme duke u llogaritur mbi kapacitetet normale prodhuese. Kosto e inventarit llogaritet duke përdorur metodën e mesatares së ponderuar.

Gjendjet e inventarit janë të vlerësuara në bilanc me koston e tyre historike, duke e konsideruar këtë vlerësim, si vlerën më të ulët midis koston dhe vlerës neto të realizueshme.

3.4. Aktive afatgjata materiale

i. Njohja dhe matja

Të gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar. Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivit. Kostoja e aktiveve të ndërtuara vetë përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivit në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe kostot e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivit. Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në "Ndërtim në proces" dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivit kur përfundon ndërtimi tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë.

Në rastet kur pjesë të një aktivi afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet, apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

ii. Kostot e mëpasshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundur që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.



3. Politikat Kontabël (vazhdim)**3.4. Aktive afatgjata materiale (vazhdim)***iii. Amortizimi*

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën e vlerës së mbetur të amortizimit mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivit afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Aktivët e marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivit.

Kategoria e aktiveve	Metoda e Amortizimit	Norma e Amortizimit
Ndërtesa	Vlera e mbetur	5%
Makineri dhe pajisje	Vlera e mbetur	20%
Pajisje informatike dhe teknike	Vlera e mbetur	25%
Mobilje zyre dhe orendi	Vlera e mbetur	20%
Mjete Transporti	Vlera e mbetur	20%

Metoda e amortizimit, jeta e dobishme dhe vlera e mbetur rishikohen në çdo datë raportimi.

iv. Çregjistrimi

Një zë i aktiveve afatgjata materiale çregjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atëherë kur nuk priten më përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerrja e tij jashtë përdorimit.

Fitimet dhe humbjet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale, përcaktohen sipas shumës së tyre të mbetur dhe merren parasysh në nxjerrjen e rezultatit operativ të vitit.

3.5. Të ardhurat

Të ardhurat njihen atëherë kur është e mundur që njësia ekonomike do të ketë përfitime ekonomike në të ardhmen dhe këto përfitime mund të maten me besueshmëri. Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të arkëtuar ose të arkëtueshme që merr parasysh shumën e çfarëdo zbritje tregtare, zbritjet për shlyerje të menjëhershme dhe zbritjet e bëra për sasi (vëllim) të blerë.

3.6. Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit paraqesin të ardhurat që përfitohen jo rregullisht gjatë rrjedhës normale të veprimtarisë ekonomike duke përfshirë, fitim/humbjet nga shitja e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, fitim/humbjet nga rivlerësimet e aktiveve afatgjate të investuara dhe fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit përveç diferencave të këmbimit që lidhen me veprimtaritë financiare dhe investuese.

3.7. Qiratë

Qiramarrjet klasifikohen si financiare ose operative që në fillimin e qirasë. Qiratë financiare njihen si aktive dhe detyrime financiare në shkallën më të ulët të vlerës së drejtë të aktivit dhe vlerës aktuale të minimumit të pagesave të qirasë në datën e blerjes. Kostot financiare regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve nën termin e qirasë me normat e zbatueshme të interesit mbi balancën e mbetur të detyrimeve.

Shoqëria ka qira operative.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.8. Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e të drejtave të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet llogarisë fitim/humbje dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

3.9. Tatimi mbi fitimin

Tatim fitimi i vitit përbëhet nga tatimi aktual dhe tatim fitimi i shtyrë. Tatim fitimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen direkt në kapital, rast në të cilin edhe tatimi njihet në kapital.

Tatimi aktual është tatimi i pritur për t'u paguar mbi fitimin e tatueshem të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e bilancit, si dhe çfarëdolloj rregullimi kontabël të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme. Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2016 është 15% (2015: 15%).

Tatim fitimi i shtyrë përfaqëson diferencën e tatimit mbi fitimit të pagueshëm (apo të rikuperueshëm) në periudhat e ardhshme, i cili përlogaritet për të evidentuar diferencat e përkohshme që krijohen për shkak të aplikimit të parimeve kontabël të ndryshme nga ato tatimore. Tatimi i shtyrë njihet sipas metodës së detyrimeve të bilancit, duke aplikuar normën tatimore në fuqi mbi diferencën ndërmjet aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të këtyre aktiveve dhe detyrimeve për qëllime tatimore.

Shoqëria nuk ka burim diferencash të përkohshme për njohjen e tatimit të shtyrë mbi fitimin.

3.10. Fondet për pensione


Shoqëria paguan kontributet ndaj sigurimeve shoqërore e shëndetësore të detyrueshme, që sigurojnë përfitimet për pensione të punonjësve në përputhje me legjislacionin shqiptar. Autoritetet Fiskale janë përgjegjëse për përcaktimin e kufirit minimal ligjor të vendosur për pensionet në juridiksionin përkatës sipas një plani kontributesh pensioni të përcaktuar.

3.11. Transaksionet me palët e lidhura

Palët e lidhura përcaktohen kur një palë kontrollohet nga pala tjetër, ose ka ndikim të rëndësishëm në vendimet e biznesit apo vendimet financiare të palës tjetër. Për qëllime të paraqitjes së pasqyrave financiare, drejtimi i shoqërisë dhe manaxhimi konsiderohen si palë të lidhura.

3.12. Provizionet

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë në të ardhmen flukse dalëse parash për shlyerjen e tij. Provizionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet që lidhen me detyrimin në fjalë. Provizionet rishikohen në çdo datë raportimi dhe nëse nuk ka më gjasa për daljen e ndonjë fluksi parash për shlyerjen e detyrimit, provizionet rimerren.



3. Politikat Kontabël (vazhdim)**3.13. Aktivitet dhe detyrimet e kushtëzuara**

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato paraqiten në shënime të pasqyrave financiare për sa kohë që mundësia për një dalje të burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e largët. Një aktiv i kushtëzuar nuk paraqitet në pasqyrat financiare por paraqitet në shënime për sa kohë ekziston mundësia e hyrjes së përfitimeve ekonomike. Shuma e humbjeve të kushtëzuara njihet si provizion, nëse është e mundshme që ngjarjet e ardhshme të konfirmojnë që një detyrim ka lindur në datën e pozicionit financiar dhe mund të bëhet një vlerësim i arsyeshëm i shumës së humbjes.

4. Mjete monetare

Mjetet monetare në arkë dhe bankë detajohen si më poshtë më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015:

	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015
Vlerë monetare në lekë	6,767,506	4,239,010
Arka	8,603	1,883
Banka	6,758,903	4,237,127
Vlerë monetare në valutë	6,435,600	81,773,240
Arka	169,501	172,071
Banka	6,266,099	81,601,169
	13,203,106	86,012,250

5. Llogari të arkëtueshme tregtare

Llogaritë e arkëtueshme përfaqësojnë llogari të arkëtueshme nga klientë dhe koston e punimeve të kryera së bashku me kostot shtesë të investitorit për objektet e përfunduara në datën e mbylljes së Pasqyrave Financiare. Llogaritë e arkëtueshme më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015
Klientë	-	3,925,784
Vlera e situacioneve me TVSH dhe kosto shtesë	802,427,140	1,233,929,948
	802,427,140	1,237,855,732

6. Të tjera llogari të arkëtueshme

Llogaritë të tjera të arkëtueshme më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015
TVSH	10,078	2,176,026
Garanci të dhëna	280,100	280,100
Të tjera	3,552,984	3,206
	3,843,162	2,459,332



ORION sh.p.k.

Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016

(Vlerat janë në Lekë)

7. Inventari


Inventari më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015 detajohet si më poshtë :

	<u>31 dhjetor 2016</u>	<u>31 dhjetor 2015</u>
Inventar i imët	863,514	863,514
Mallra	38,352,711	15,669,491
	<u>39,216,225</u>	<u>16,533,005</u>

8. Parapagimet dhe shpenzime të shtyra

Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra detajohen si më poshtë më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015:

	<u>31 dhjetor 2016</u>	<u>31 dhjetor 2015</u>
Parapagime	14,924,320	17,881,217
Shpenzime të periudhave të ardhshme	469,774,062	14,242,244
	<u>484,698,382</u>	<u>32,123,461</u>



ORION sh.p.k.

Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016

(Vlerat janë në Lekë)

9. Aktive Afatgjata Materiale

Kosto

Gjendja më 1 janar 2015	34,002,136	4,730,499	4,580,347	1,479,572	-	44,792,554
Shtesa			52,500			52,500
Nxjerrje jashtë përdorimit						-

Gjendja më 31 dhjetor 2015

	34,002,136	4,730,499	4,632,847	1,479,572	-	44,845,054
--	-------------------	------------------	------------------	------------------	----------	-------------------

Shtesa

		103,380	1,212,700	960,867	691,500	2,968,447
--	--	---------	-----------	---------	---------	-----------

Nxjerrje jashtë përdorimit

						-
--	--	--	--	--	--	---

Gjendja më 31 dhjetor 2016

	34,002,136	4,833,879	5,845,547	2,440,439	691,500	47,813,501
--	-------------------	------------------	------------------	------------------	----------------	-------------------

Amortizimi i akumuluar

Gjendja më 1 janar 2015	2,702,980	2,807,724	3,195,811	702,664		9,409,179
Amortizimi i vitit	1,564,958	384,555	349,415	155,381		2,454,309
Nxjerrje jashtë përdorimit						-

Gjendja më 31 dhjetor 2015

	4,267,938	3,192,279	3,545,226	858,045	-	11,863,488
--	------------------	------------------	------------------	----------------	----------	-------------------

Amortizimi i vitit

	1,486,710	318,602	405,875	229,790	69,150	2,510,127
--	-----------	---------	---------	---------	--------	-----------

Nxjerrje jashtë përdorimit

						-
--	--	--	--	--	--	---

Gjendja më 31 dhjetor 2016

	5,754,648	3,510,881	3,951,101	1,087,835	69,150	14,373,615
--	------------------	------------------	------------------	------------------	---------------	-------------------

Vlera neto kontabël

Gjendja më 31 dhjetor 2015	29,734,198	1,538,220	1,087,621	621,527	-	32,981,566
Gjendja më 31 dhjetor 2016	28,247,488	1,322,998	1,894,446	1,352,604	622,350	33,439,886

10. Aktive afatgjata jomateriale

	AAJM	TOTALI
Me kosto		
Gjendja më 1 janar 2015	37,800	37,800
Shtesa		-
Pakësime		-
Gjendja më 31 dhjetor 2015	37,800	37,800
Shtesa		-
Pakësime		-
Gjendja më 31 dhjetor 2016	37,800	37,800
Amortizimi		-
Gjendja më 1 janar 2015	20,535	20,535
Amortizimi i vitit	2,590	2,590
Pakësime		-
Gjendja më 31 dhjetor 2015	23,125	23,125
Amortizimi i vitit	2,201	2,201
Pakësime		-
Gjendja më 31 dhjetor 2016	25,326	25,326
		-
Gjendja Neto me 31 dhjetor 2015	14,675	14,675
Gjendja Neto me 31 dhjetor 2016	12,474	12,474

11. Hua afatshkurtra

Huatë afatshkurtra më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015
Overdraft nga Societe Generale	19,198	18,901
Overdraft nga Union Bank	35,645,268	-
	35,664,466	18,901

12. Llogari të pagueshme tregtare

Llogaritë e pagueshme më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015
Furnitorë	165,407,807	89,091,990
	165,407,807	89,091,990

13. Llogari të pagueshme ndaj palëve të lidhura

Llogari të pagueshme ndaj palëve të lidhura më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015 detajohen si më poshtë:

	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015
Detyrime ndaj ortakëve	204,443,534	217,578,908
Dividendë për t'u paguar	12,746,916	-
	217,190,450	217,578,908

14. Detyrime tatimore

Detyrimet tatimore më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015
TVSH për t'u paguar	800,637	-
Detyrime për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore	440,798	305,192
Detyrime për tatimin mbi të ardhurat personale	175,376	123,289
Tatim fitimi	2,133,754	880,284
Të tjera detyrime	-	1,000
	3,550,565	1,309,765

15. Parapagime të arkëtuara

Në këtë zë janë përfshirë paradhëniet e marra nga klientët për kontrata porosisë për blerje apartamentesh, dyqanesh etj, gjendja e të cilave më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015 si më poshtë:

	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015
Parapagime të marra	507,631,496	678,317,848
	507,631,496	678,317,848

16. Të tjera detyrime

Detyrimet e tjera më 31 dhjetor 2016 dhe 2015 për kompaninë vijnë si më poshtë :

	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015
Kreditorë të tjerë	27,274,503	23,197,384
Paga për t'u paguar	62,620	32,270
	27,337,123	23,229,654



ORION sh.p.k.**Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016***(Vlerat janë në Lekë)***17. Kapitali**

Kapitali i nënshkruar i shoqërisë është 39,000,000 Lekë, 75 kuota zotërohen nga ortaku Ardian Nelo dhe 25 kuota nga ortaku Niazi Nelo.

	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015
Numri i kuotave	100	100
Vlera nominale (në Lekë)	390,000	390,000
Kapitali i nënshkruar	39,000,000	39,000,000

Rezerva ligjore nuk ka ndryshim nga vitit paraardhës dhe paraqitet në shumën 17,488,822 Lekë.

Rezerva të tjera paraqiten në vlerën 321,944,133 Lekë (2015: 311,784,751 Lekë).

Fitimi për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 është 41,625,513 Lekë.

18. Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit

Të ardhurat nga aktiviteti i shfrytëzimit detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015
Të ardhura nga punimet, situacionet në objekte	325,538,487	-
Të ardhura nga mbyllja e shitjeve të objekteve	14,320,932	53,625,315
	339,859,419	53,625,315

19. Të ardhura të tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera nga shfrytëzimi për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 dhe 2015 janë si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015
Të ardhura nga këmbimet valutore nga aktiviteti operativ	6,013,214	9,469,397
Të ardhura nga qiraja	524,160	1,802,700
	6,537,374	11,272,097

20. Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme

Shpenzimet për lëndë të para dhe materiale të konsumueshme detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015
Materiale dhe lëndë të para të konsumuara	179,550,858	2,257,607
Punime nga të tretë	87,257,046	-
	266,807,904	2,257,607

21. Të tjera shpenzime

Shpenzimet e tjera për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015 paraqiten si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015
Mirëmbajtje dhe riparime	788,015	784,697
Shërbimi i sigurimit dhe ruajtjes së objektit	2,162,926	235,000
Shërbime kontabiliteti dhe financiare	1,410,000	1,410,000
Shërbime ligjore	228,420	151,540
Shërbime postare dhe telekomunikacioni	310,610	611,394
Tatime dhe taksa të ndryshme	1,131,326	98,576
Shërbime bankare	1,216,686	287,560
Blerje energji, ujë	781,426	512,340
Shpenzime kancelarie	663,650	460,090
Shpenzime për pritje dhe përfaqësim	-	398,980
Shpenzime transporti	116,241	76,903
Shpenzime të tjera	2,825,735	99,987
	11,635,035	5,127,067

22. Shpenzime të personelit

Shpenzimet e personelit detajohet si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015
Shpenzime për paga	14,323,610	15,807,191
Shpenzime për sigurime shoqërore e shëndetësore	1,931,880	2,216,450
	16,255,490	18,023,641

Numri i punonjësve më 31 dhjetor 2016 është 25 (2015:16).

23. Shpenzime konsumi dhe amortizimi

Shpenzimet e zhvlerësimit dhe amortizimit detajohet si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015
Shpenzime amortizimi	2,512,328	2,456,899
	2,512,328	2,456,899

24. Shpenzime të tjera të shfrytëzimit

Shpenzimet e tjera të shfrytëzimit paraqesin gjokat dhe penalitetet për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015
Gjoka dhe dëmshpërblime	189,435	1,332,556
	189,435	1,332,556

25. Shpenzime interesi dhe shpenzime të ngjashme

Shpenzimet e interesit detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015
Të ardhura nga interesat	8,021	17,141
	8,021	17,141

26. Shpenzimi i tatimit mbi fitimin

Përlllogaritja e shpenzimit për tatimin mbi fitimin paraqitet më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015:

	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015
Fitimi para tatimit	49,004,622	35,716,783
Total shpenzime të panjohura	189,435	1,332,556
Fitimi para tatimit (përfshirë shpenzimet e panjohura)	49,194,057	37,049,339
Humbje fiskale e mbartur	-	-
Tatim fitimi @15%	7,379,109	5,557,401
	41,625,513	30,159,382

27. Transaksionet me palët e lidhura

Balancat dhe transaksionet me palët e lidhura më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015
Detyrime për dividendë	12,746,916	37,448,752
Hua afatgjatë nga ortakët	204,443,534	180,130,156
	217,190,450	217,578,908

ORION sh.p.k.

Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016

(Vlerat janë në Lekë)

28. Angazhime dhe pasiguri

Çështje gjyqësore

Gjatë aktivitetit të saj të zakonshëm, Shoqëria mund të përfshihet në pretendime apo veprime të ndryshme ligjore nga palë të treta. Bazuar në opinionin e drejtuesve të Shoqërisë, konkluzioni përfundimtar në lidhje me këto çështje nuk do të ketë efekte negative në pozicionin financiar të Shoqërisë ose ndryshime në aktivet neto të saj. Me 31 dhjetor 2016 shoqëria nuk ka asnjë çështje gjyqësore të hapur kundrejt saj apo nga ajo, që mund të kërkojë rregullime të këtyre pasqyrave financiare.

Detyrimet tatimore

Librat e shoqërisë nuk janë audituar nga organet tatimore për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016. Si rrjedhojë detyrimet tatimore nuk mund të konsiderohen përfundimtare. Detyrime të mundshme që mund të rezultojnë nga një auditim i organeve tatimore nuk mund të maten në menyrë të besueshme.

29. Ngjarje pas bilancit

Nuk ka asnjë ngjarje pas datës së bilancit e cila kërkon rregullime apo shpjegime në këto pasqyra financiare.

